



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr.2968/1Prot.

Tiranë më.21.06.2018

## VENDIM

**Nr. 22, datë 21.06.2018**

***“Për hapjen e dy programeve të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” në Mësuesi për arsimin e mesëm të lartë, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja”***

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 7; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, gërma “dh”; neni 75, pika 3; Udhëzimin Nr.31, datë 29.12.2017, Kreu I, pika 2; Kreu II, pika 1 dhe Kreu IX pika 1; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 19, pika 1; neni 20; si dhe në propozimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja me shkresat Nr.655 Prot. dhe 656 Prot., datë 13.06.2018, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 21.06.2018,

## VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për hapjen programit të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” në “Mësuesi në gjuhën turke për arsimin e mesëm të lartë”, në Departamentin e Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të UT-së.
2. Të miratojë propozimin për hapjen programit të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” në “Mësuesi në gjuhën greke për arsimin e mesëm të lartë”, në Departamentin e Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të UT-së.
3. Propozimi dhe dokumentacioni i plotë të përcillet në Ministrinë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për vijimin e procedurave

**KRYETARI**

**PROF.DR. MYNYR KONI**